



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodotato Received/Delivered	15.07.2022	2	viti god year
Organ/Institucia Org./Unit	Nr. Prot. Pr. No.	Shtypja Protog. Appendix	Sasia Kopjerna Quantity
SKDMSHCK	4134/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.585/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.585/2022 të datës 30.06.2022, të parashtruar nga ankuesi

cilin e përfaqëson Avokat

kundër organit të punësimit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, në çeshtjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.585/2022 të datës 30.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me datë 14.03.2022 ka shpallur konkursin me numër të referencës SHSKUK-02/2022-03/1 për vendin e punës "Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe i pa kënaqur me njoftimin e datës 01.06.2022 për përzgjedhje përfundimtare të kandidatit me datë 06.06.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Komunës së Prizrenit, i cili komision me datë 22.06.2022 i refuzohet ankesa e ankuesit si e pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 22.06.2022 të Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit, me datë 28.06.2022 parashtron ankesë nëpërmjet Postës së Kosovës për

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 30.06.2022 me numër të protokollit 3827/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 30.06.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 22.06.2022 i Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit; Autorizimi për përfaqësim; Njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve i datës 01.06.2022; Njoftimi i datës 26.05.2022 si dhe Konkursi i datës 14.03.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit. sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 14.03.2022 të shpallur nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës për vendin e punës "Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së".

Duke ju referuar Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, respektivisht nenit 62 paragrafit 6 përcaktohet që: *"Të punësuarit në SHSKUK nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës",* rrjedhimisht në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë janë kategorizuar si nëpunës të shërbimit publik siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2, ndërsa lidhur me këtë paragrafi 4 i nenit 2 të këtij ligji, përcakton që: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike".*

Ndërlidhur me këtë pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit publik, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për shqyrtimin e ankesës vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.585/2022 të datës 30.06.2022, e parashtruar nga ankuesi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.
Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr. 585/202

Valentina Kaçandoli BEKTESHI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuarit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
- Arkivot të KPMSHCK-së.